



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AC-I-22-0541-A0001

Në çështjen juridike të:

Paditësi/ankuesi

H B, nga fshati B, Komuna Suharekë.

Kundër:

E paditura

N.SH "25 Maji" –Suharekë (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër Aktvendimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-14-1129, të datës 22 korrik 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 04 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Shkallës së parë i DHPGJSK-së C-IV.-14-1129, i datës 22 korrik 2022.**
- 3. Lënda kthehet në rigjykim më Shkallë të I-rë tek gjyqtari përkatës i DHPGJSK-së.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 26 shkurt 2014, paditësi ka dorëzuar padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër vendimeve të Autoriteti të Likuidimit (AL) nr. PRZ045-0242, PRZ045-0243 dhe PRZ045-0244 të datës 31 janar 2014, me te cilat kërkesat e tij për 3 paga të papaguara, për shkak të ndërprerjeje së marrëdhënies së punës, si dhe për 18 paga të papaguara për periudhën 01 korrik 2007 deri me 31 dhjetor 2008, ishin refuzuar si të pabazuar nga N.SH "25 Maji" –Suharekë (në likuidim). Paditësi kishte theksuar se ka qenë punëtor i NSH-së "25 Maji" dhe ka kërkuar nga Gjykata kompensimin e të ardhurave si në vijim: tri pagat e pa paguar në shumë prej 1,548.00 euro, 18 pagat e pa paguara për periudhën 1 korrik 2007-31 dhjetor 2008 në shumë prej 9,288.00 euro si dhe kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 3,612.00 euro. Paditësi në padinë e parashtruar e konteston çështjen e parashkrimit në të cilën janë bazuar vendimet e Autoriteti të Likuidimit. Paditësi ka kërkuar nga shkalla e I-rë e DHPGJS-së që ti anulojë vendimet e kundërshtuara të AL, dhe ta aprovojë padinë si të bazuar në ligj. Në mbështetje të pretendimeve të tij paditësi i kishte bashkangjitur këto prova: -kopjet e vendimeve të AL, kopjen e njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës në NSH "25 Maji" –Suharekë të datës 27 mars 2009.

Më 8 qershor 2022, Shkalla e I-rë kishte lëshuar për paditësin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore në shumë prej 30 eurove, duke e njoftuar se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, padia do të konsiderohet e tërhequr. Në bazë të flete kthesës e cila gjendet në shkresat e lëndës gjykata vëren se është tentuar përmes postës që të bëhet dorëzimi i vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore të paditësi po që dorëzimi ka rezultuar të jetë i pasuksesshëm për arsye se adresa e dhënë është e pa njohur, më 14 qershor 2022 dhe 22 qershor 2022.

Pas dështimit të dorëzim-pranimi të vërejtjes, në bazë të nenit 26, paragrafi 5 I ligjit nr.06/L086 për Dhomën e Posaçme, nenit 116.5 dhe 116.6 të LPK-së gjyqtari

e urdhëron Zyrën e regjistrit që të afishoj (publikoj) në tabelën e shpalljeve nga data 12 korrik 2022 deri më 20 korrik 2022.

Më 22 korrik 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së, kishte marrë Aktvendimin C-IV.-14-1129, me të cilin ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr. Në arsyetim të vendimit thuhet se ankuesi konform dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkangjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Në Vazhdim të dispozitës së nenit 253.5, parsheh: Në qoftëse se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr. Shkalla e I-rë është mbështetur në Udhëzimin Administrativ Nr.01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1 parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore. Shkalla e I-rë në arsyetim të vendimit thekson se i ka shfrytëzuar të gjitha rrugët ligjore për të realizuar dorëzimin e vërejtjes të paditësi për pagesën e taksës gjyqësore por një gjë e tillë nuk ka qenë e mundur në adresën e dhënë. Po ashtu Shkalla e I-rë me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor ka bërë edhe afishimin (publikimin) e vërejtjes në tabelën e shpalljeve me qëllim të informimit të palës në procedure për përmbushjen e detyrimit në kuptim të pagesës së taksës gjyqësore.

Më 23 shtator 2022, paditësi/ankuesi ka parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër aktvendimit C-IV.-14-1129, me të cilën ka propozuar që të që ta kthejë në rivendosje-në gjendjen e mëparshme me rekomandim që ti iepët e drejta dhe të informohen për taksën në mënyrë që të vazhdohet me procedure të rregullt deri në vendimin meritor lidhur me padinë dhe krekëspadinë e tij te ushtruar ne Gjykatë. Paditësi në ankesë e tij thekson se nuk ka qenë në dijeni për ndonjë njoftim të gjykatës që ka të bëjë me pagesën e taksës gjyqësore për këtë çështje, dhe kjo mund të vërtetohet nga shkresat e lëndës në fletën kthesën për njoftimin që më siguri nuk figuron nënshkrimi im në atë shkresë. Ankuesi thekson se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së nuk ka asnjë sqarim dhe argumentim se ai si paditësit apo ndonjë I autorizuar i tij e ka marrë njoftimin e gjykatës për taksën gjyqësore, por

Gjykata vetëm shënon se nuk ka pasur mundësi të i dorëzohet vërejtja në adresën e dhënë nga paditësi kjo nuk është e saktë sepse, tani këtë Aktvendimin me të cilin e atakoj si e ka marr dhe si gjetën tani. Andaj duke pas parasysh këto arsye paditësi konsideron se arsyetimi Shkallës së I-rë i DHPGJS nuk është i saktë. Paditësi thekson se po ta kishte marrë një njoftim të tillë, si palë e interesuar dhe paditës për kërkesat e tij do të i kishte paguar ose do të kishte kërkuar nga gjykata që të ta e liroj nga pagesa për shkak të kushteve të vështira ekonomike pasi që është pensioner dhe jeton vetëm me të ardhurat e pensionit. Paditësi po ashtu thekson se nuk ka qenë në dijeni dhe pa fajin e tij nuk i është dhënë kjo e drejtë për të kryer obligimet e tij për realizimin e të drejtës së tij të garantuar me ligj.

Më 19 dhjetor 2023, AKP-ja ka parashtruar përgjigje në ankesë me të cilën i kundërshton pretendimet ankimore të paditësit dhe i propozon Kolegjit të Apelit që ta refuzojë ankesën si të pa bazuar dhe ta vërtetojë aktvendimin e Shkallës së I-rë. AKP-ja thekson se lidhur me argumentet e ankesës është qartësisht dhe mjaftueshmërisht e sqaruar në mbrojtjen e parashtruar si dhe në Aktvendimin me nr.C-IV.-14-1129 nga DHPGJS, pranë shkallës së I-rë. Përsëritja e atyre argumenteve të cilat janë parashtruar më pare do të ishte e padobishme për mbarëvatjen e procedurës, për këtë arsye pala kundërshtarë i parashtron Kolegjit të Apelit që t'i referohet mbrojtjes së Aktvendimit përkatës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktvendimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj si i tillë duhet të anulohet dhe të kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi më 09 tetor 2013, ka dorëzuar tek Autoritet e Likudimit të N.SH "25 Maji" (në likudim), një kërkesë për tri pagat e pa paguar në shumë prej 1,548.00 euro, 18 pagat e pa paguara për periudhën 1 korrik 2007-31 dhjetor 2008 në shumë prej 9,288.00 euro si dhe kërkesën për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 3,612.00 euro, por që kërkesat ishin refuzuar si të pavlefshme me arsyetimin se janë parashkruar konform nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar.

Me 26 shkurt 2014, kundër këtyre vendimeve të AL paditësi kishte parashtruar padi në DHPGJS.

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktvendimin e ankimuar ankesën e paditësit e ka konsideruar të tërhequr për arsye se paditësi nuk e kishte paguar taksën gjyqësore.

Paditësi në ankesën e parashtruar pranë Kolegjit të Apelit thekson se nuk ka qenë në dijeni për ndonjë njoftim të gjykatës që ka të bëjë me pagesën e taksës gjyqësore për këtë çështje, dhe kjo mund të vërtetohet nga shkresat e lëndës në fletën kthesën për njoftimin që më siguri nuk figuron nënshkrimi im në atë shkresë. Ankuesi thekson se shkalla e I-rë e DHPGJS-së nuk ka asnjë sqarim dhe argumentim se ai si paditës apo ndonjë i autorizuar i tij e ka marrë njoftimin e gjykatës për taksën gjyqësore, por vetëm shënon se nuk ka pasur mundësi të i dorëzohet vërejtja në adresën e dhënë nga paditësi kjo nuk është e saktë sepse, tani këtë Aktvendimin me të cilin e atakoj si e ka mundësi që e ka marr, si e kanë gjetur tani adresën.

Kolegji i Apelit pasi që shqyrtoi pretendimet e palëve, dhe analizoi në detaje shkresat e lëndës erdhi në përfundim se pretendimet e paditësit / ankuesit janë të bazuara. Kolegji i Apelit vlerëson se Aktvendimi i Shkalla e I-rë e DHPGJS-së nuk është i drejtë meqë zyra e Zyra e Regjistrimit të DHPGJS-së gabimisht e ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore në adresë jo të saktë e cila adresë sipas vërejtjes që i është dërguar paditësit ishte H B, me të cilën zarfi ishte kthyer me shënim pala e panjohur. Kolegji i Apeli vëren se adresa e saktë e paditësit/ankuesit

është adresa sikurse në padinë parashtruar pranë DHPGJS-së e cila ishte H B nga Fshati B, Komuna e Suharekës ku po në këtë adresë i është dorëzuar edhe Aktvendimi i atakuar paditesit/ankuesit dhe i cili e kishte pranuar më 12 shtator 2022.

Për këto arsye Kolegji i Apelit e udhëzon Shkallën e I-rë të DHPGJS-së që në rigjykim ta komunikoj me paditësin në adresën e paditësit të shënuar si në padi e jo në adresën të cilën e kishte si komunikim tek AL.

Prandaj, Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e paditësit/ankuesit është e bazuar mbi arsyet e cekura më lartë dhe aktvendimi i ankimuar nuk është i drejtë dhe si i tillë duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim në shkallë të I-rë tek Gjyqtari përkatës.

Andaj në bazë të neit 9.10 të LDHP-së është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Taksa gjyqësore

Pasi që Taksat gjyqësore janë paguar konform nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ankuesi nuk ngarkohet me takes shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 04 prill 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues _____